



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



RREGULLORE
PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË

Janar 2021, Mitrovicë

<u>PËRMBAJTJA</u>	<u>Faqe</u>
I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	3
II. ORGANIZIMI I SIGURISË NË PUNË	5
1. Dokumenti për vlerësim dhe parandalim e rrezikshmërisë në vendin e punës	6
2. Obligimet e punëdhënësit	8
3. Shërbimi i shpëtimit dhe i zjarrfikësve	9
4. Punonjësit profesional për sigurinë dhe shëndetin në punë në minierë	9
5. Obligimet për marrjen e masave për sigurinë dhe shëndetin në punë	9
6. Konstatimi i aksidentit në punë	11
7. Të drejtat dhe obligimet e Zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë	13
8. Obligimet e Departamentit për Siguri dhe Shëndet në Punë	14
9. Të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësit	14
III. TRAJNIMI DHE AFTËSIMI NGA LËMIA E SIGURISË NË PUNË	18
IV. MBROJTJA E TË RINJËVE, GRAVE DHE PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	19
V. FURNIZIMI, SHFRYTËZIMI, KONTROLLIMI I KOHËPASKOHSHËM I MJETEVE, PAJIMEVE DHE I VEGLAVE PËR PUNË	19
VI. MASAT E SIGURISË NË OBJEKTE	20
VII. MASAT E SIGURISË GJATË PËRDORIMIT TË MJETEVE TË PUNËS	24
VIII. MASAT E SIGURISË GJATË TRANSPORTIT TË PUNONJËSVE	26
IX. USHQIMI I PUNONJËSVE	27
X. MBROJTJA SHËNDETSORE	27
XI. EVIDENCA LIDHUR ME AKSIDENTET NË PUNË	29
XII. BURIMI I LËNDIMIT NË PUNË	31
XIII. LIBRAT E KONTROLLIT	36
XIV. SHENJAT E SIGURISË	38
XV. INFORMIMI I PUNONJËSVE	39
XVI. DISPOZITAT NDËSHKUESE	39
XVII. DISPOZITAT PERFUNDIMTARE	40

Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, nenit 34 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 8 të Statutit të Trepça Sh.A, Bordi i Përkohshëm Mbikëqyrës i Trepça Sh.A., në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2020, miraton këtë:

RREGULLORE
PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me Rregulloren për Siguri dhe Shëndetin në Punë, (në tekstin në vijim: Rregullore) përcaktohen te drejtat, detyrat dhe obligimet e punonjësve dhe personave tjerë të Trepça Sh.A. me seli në Parkun Industrial në Mitrovicë, (në tekstin në vijim: Trepça) nga siguria në punë, organizimi i mbrojtjes në punë, detyrat dhe obligimet e organeve përgjegjëse te punëdhënësit dhe të punonjësve për sigurimin e kushteve optimale nga siguria dhe shëndeti në punë.

Neni 2

1. Dispozitat ligjore dhe të akteve nënligjore që e rregullojnë lëmin e sigurisë dhe shëndetit në punë, aplikohen drejtpërsëdrejti.
2. Punëdhënësi është i detyruar të udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të punësuarit.
3. Punëdhënësi është i detyruar që të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale, nëse nuk i ka siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve të punësuarit në pikëpamje shëndetësore.

Neni 3

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Punëdhënësi:** Personi juridik i cili siguron punë për një ose më shumë të punësuar, i paguan pagën të punësuarit/ve për punën ose shërbimet e kryera dhe është përgjegjës për subjektin punues;
 - 1.2. **I punësuar:** Personi fizik i cili kryen punë ose shërbime me pagesë për punëdhënësin dhe ka marrëdhënie punësimi me punëdhënësin;

1.3. **Siguria dhe shëndeti në punë:** Pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës, duke ndërmarrë masat parandaluese, që kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të punësuarve dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punës;

1.4. **Risk:** Mundësia që të punësuarit t'i shkaktohet plagë, sëmundje ose probleme shëndetësor të menjëhershme apo të mëvonshme, si rezultat i ekspozimit në ambientin e punës ku paraqiten elemente të dëmshme kimike, fizike dhe biologjike, mjeteve të punës dhe makinerive pa pajisje mbrojtëse dhe të pasigurta për përdorim, mënyrës së gabuar të përdorimit të mjeteve të punës dhe makinerive si dhe mënyrës së gabuar të organizimit të punës;

1.5. **Risk i mundshëm dhe serioz:** Veprimtari e identifikueshme, që paraqet rrezik, dhe e cila në një periudhë të shkurtër kohore mund të shkaktoj dëme materiale ose dëme në njerëz;

1.6. **Sëmundje profesionale:** Çdo sëmundje e shkaktuar nga ekspozimi në elementet e dëmshme dhe të rrezikshme kimike, fizike dhe biologjike në ambientin e punës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës;

1.7. **Masat parandaluese:** Të gjitha veprimet e ndërmarra dhe të planifikuara në të gjitha proceset e punës në subjektin punues për të evituar dhe minimizuar riskun që shkaktohet nga ushtrimi i veprimtarisë së punës;

1.8. **Vendet e punës:** Përfshijnë të gjitha vendet dhe hapësirat nën mbikëqyrjen direkt dhe indirekte nga punëdhënësit ku të punësuarit duhet të kryejnë aktivitete pune dhe të qëndrojnë gjatë procesit të punës;

1.9. **Dokument i vlerësimit të riskut:** Dokumenti ku përshkruhen karakteristikat e procesit të punës, identifikimi i burimit të riskut, përcaktimi kush mund të rrezikohet, nga çfarë rrezikohet dhe si, vlerësimi i riskut për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe përcakton masat e nevojshme dhe të domosdoshme, që duhet të ndërmerren për t'i përparuar këto masa në pajtim me rinvlerësimet që do të bëhen kohë pas kohë;

1.10. **Personi i ngarkuar për sigurinë dhe shëndetin në punë:** Profesionist i cili është i punësuar te punëdhënësi dhe është i caktuar për të kryer detyra që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë;

1.11. **Persona ose shërbime të specializuara:** Personat fizikë ose juridikë, jashtë subjekteve punuese të kualifikuar dhe të licencuar, për të kryer veprimtarinë nga siguria dhe shëndeti në punë në pajtim me këtë ligj;

1.12. **Aksident në punë ose për shkak të punës:** Çdo ngjarje të papritur gjatë procesit të punës, që shkakton dëmtimin të menjëhershëm trupor të punonjësve, dëmtim që sjell paaftësi të përkohshme, paaftësi të përhershme ose që sjell vdekje, si dhe çdo dëmtim tjetër të shëndetit që lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e veprimtarisë së punës;

1.13. **Inspektorati i Punës:** Organ i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit të punës, të sigurisë dhe shëndetit në punë;

1.14. **Inspektorati i Minierave:** Departament në kuadër të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerare, i cili ushtron funksionet dhe kompetencat në pajtim me Ligjin për miniera dhe minerale;

1.15. **Ekipe të shpëtuese:** Janë specialistët e minierës të certifikuar për shpëtim;

1.16. **Mbrojtja e jetës së punonjësve:** Qëllimi i mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të punëtorëve nga lëndimet në punë dhe nga sëmundjet profesionale, parandalimi i shkaqeve të lëndimeve e dëmtimeve të shëndetit në punë dhe krijimi i kushteve sa më të mira të punës në ndërmarrje;

1.17. **Minierë:** Sipas përkufizimit me Ligjin për miniera dhe minerare;

1.18. **Veprimtari minerare:** Tërësia e veprimeve që kryhen në nëntokë dhe në sipërfaqe me qëllim të hulumtimit, zbulimit, shfrytëzimit dhe përpunimit të mineraleve.

II. ORGANIZIMI I SIGURISË NË PUNË

Neni 4

1. Për të mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e punonjësve Trepça Sh.A. merr masat e nevojshme për të siguruar që:

1.1. vendet e reja të punës të projektohen, ndërtohen, pajisen, të vihen në veprim, të shfrytëzohen dhe të mirëmbahen në një mënyrë të tillë që punonjësit të mund ti kryejnë punët dhe detyrat e punës pa iu rrezikuar siguria dhe shëndeti i tyre;

1.2. vendet e punës ku janë të angazhuar të punësuarit, të jenë nën mbikëqyrje të personit përgjegjës;

1.3. puna e cila përfshin risk të veçanta, i besohet vetëm punonjësit të kualifikuar dhe të trajnuar i cili i kryen punët në përputhje me udhëzimet e dhëna;

1.4. pajisjet personale të mbrojtjes në punë të jenë gjithmonë në gjendje të rregullt;

1.5. të gjitha udhëzimet e sigurisë dhe shëndetit në punë, të jenë të qasshme dhe kuptueshme për të gjithë punonjësit;

1.6. pajisjet e ndihmës së parë të jenë të siguruara dhe të kontrolluara në aspektin e skadencës;

1.7. të gjitha trajnimet dhe perfeksionimet profesionale të kryhen sipas intervaleve të parapara me planin përkatës; dhe

1.8. të bëhet përcaktimi dhe vlerësimi i riskut të cili i ekspozohen të punonjësit në vendin e punës.

1. Dokumenti për vlerësim dhe parandalim të riskut në vendin e punës

Neni 5

Me rastin e përpilimit të dokumentit për vlerësimin dhe parandalimin e riskut në vendin e punës, punëdhënësi duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat, kushtet e punës si dhe të gjitha masat e nevojshme, të cilat shërbejnë për siguri dhe mbrojtje shëndetësore të punësuarve. Dokumenti për vlerësim dhe parandalim të riskut në vendin e punës duhet të jetë në dispozicion në çdo njësi biznesore dhe i çastshëm për çdo punonjës.

Neni 6

Risku mund të grupohet nga:

1. Konstruktimi dhe pajisjet në vendin e punës;
2. Ndikimet fizike, kimike dhe biologjike;
3. Konstruktimi, zgjedhja dhe përdorimi i mjeteve, materialit, përbërësve të pajisjeve dhe zbatimi i tyre;
4. Konstruktimi i sistemeve të punës, prodhimit, rrjedhës së punëve, orarit të punës dhe ndikimet e ndërsjella;
5. Kualifikimi dhe trajnimi i punëmarrësve në pajtim me standardet evropiane.

Neni 7

1. Dokumenti për vlerësim dhe parandalim të riskut në vendin e punës duhet të përmbajë:

1.1 a janë hetuar rreziqet, të cilave u janë nënshtruar grupet posaçërisht të rrezikuara të punësuarve, në vendet e punës dhe punishtet përkatëse, a u janë nënshtruar vlerësimit dhe cilët janë rezultatet e vlerësimit të dhënë të riskut;

1.2. a janë marrë masa përkatëse teknike, organizative dhe personale për sigurinë dhe mbrojtjen shëndetësore të punësuarve;

1.3. punishtet dhe pajisjet a janë të rregulluara, të ushtruara dhe të mirëmbajtura në mënyrë të sigurt;

1.4. të punësuarit a informohen në mënyrë të përshtatshme për riskun për siguri dhe shëndet në punë, si dhe për masat mbrojtëse dhe masat për parandalimin e riskut në të gjitha punishtet përkatëse.

Neni 8

1. Me rastin e përpilimit të dokumentit për vlerësim dhe parandalim të riskut në vendin e punës duhet para së gjithash të merren parasysh ato rreziqe, që mund të dalin përmes:

- 1.1. rregullimit dhe pajisjes së punishteve dhe të vendeve të punës;

1.2. rregullimit, përzgjedhjes dhe përdorimit të mjeteve të punës, sidomos të makinave, aparateve dhe pajisjeve, pastaj të lëndëve të punës, si dhe nga mënyra e operimit me mjetet e punës dhe me lëndët e punës;

1.3. gjendjes së njohurive, vëllimit të përvojave dhe nga përshtatja fizike e të punësuarve.

2. Punëdhënësi duhet ta rishikojë dhe plotësojë dokumentin për vlerësim dhe parandalim të riskut në vendin e punës sipas paragrafit 1 të këtij neni, në këto raste:

2.1. nëse vendi i punës apo punishtja kanë pësuar ndryshime, zgjerime apo ri rregullime të rëndësishme, ose;

2.2. për të shmangur përsëritjen e ngjarjeve, të cilat ndërlidhen me nën paragrafët 1.1. dhe 1.2. të nenit 72 të Ligjit për miniera dhe minerale.

3. Rezultati i verifikimeve të rregullta sipas paragrafit 2 të këtij neni, duhet të regjistrohet me shkrim në rast të masave të marra mbi bazën e dokumentit për vlerësim dhe parandalim të riskut në vendin e punës.

Neni 9

1. Gjatë realizimit të punimeve minerare, hulumtimit, hapjes, përgatitjes dhe të shfrytëzimit të lëndëve të para minerare, si dhe gjatë punimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore, aplikohen masa mbrojtëse të caktuara me dispozitat ligjore të masave teknike dhe të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

2. Objektet minerare dhe pajisjet tjera që shërbejnë për punonjësit, duhet të jenë në gjendje sipas rregulloreve dhe dispozitave ligjore në fuqi dhe masave teknike të mbrojtjes në punë, gjatë zbatimit të punimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore.

3. Në vendet e punës të rrezikuara nga ndikimi i pluhurit agresiv mineral, puna lejohet vetëm nëse prezenca e pluhurit agresiv në atmosferën e minierës nuk i tejkalon standardet e lejuara sipas dispozitave ligjore në fuqi.

3.1. Trepça Sh.A. është e detyruar që së paku dy herë në vit të kontrollojë çdo vend të punës në të cilën mund të lajmërohet pluhuri agresiv dhe të konstatohet shkalla e koncentrimit të tij në ambientin e minierës.

3.2. Në vendet me rrezikshmëri të lartë, është e obliguar që të bëhen kontrole të përhershme të prezencës së pluhurit agresiv dhe të konstatojë shkallën e koncentrimit të tij.

4. Punonjësit që zbatojnë operacione teknologjike gjatë kryerjes së punimeve minerare, në raste të ndërrimit të punishtes në të cilin më parë nuk kanë punuar dhe para fillimit të punës, personi përgjegjës duhet t'i njoftojë ata me rreziqet specifike në vendet e reja të punës dhe t'i njoftojë me masat teknike dhe masat e mbrojtjes në punë, të cilat kanë të bëjnë me vendin e ri të punës.

5. Hapësirat minerare në të cilat kryhen punë minerare ose që shërbejnë për kalim të njerëzve, informacioni dhe sinjalistika, ajrosja, transporti, hapësirat për largimin e ujërave, duhet të jenë të mirëmbajtura dhe të siguruara sipas dispozitave në fuqi.

6. Trepça Sh.A. duhet të ketë planin e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga rreziqet kolektive, të cilat mund të paraqiten në minierë.

1. Obligimet e punëdhënësit

Neni 10

1. Për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e punonjësve, punëdhënësi ka për detyrë që:

1.1. të zbatojë me kohë të gjitha masat e mbrojtjes në punë, të përcaktuara me dispozitat e legjislacionit në fuqi;

1.2. me akte të veçanta për mbrojtjen në punë, të rregulloj funksionimin e masave të mbrojtjes në punë, në harmoni me organizimin e punës dhe me veçoritë e rreziqet që mund të shfaqen;

1.3. të organizojë shërbimin e mbrojtjes në punë, t'u siguroj punonjësve mjetet për mbrojtje personale, dhe mbrojtje kolektive;

1.4. të organizojë shërbimin për shpëtim dhe atë të ndihmës së parë, shërbimin e mbrojtjes nga zjarri, mbrojtjes nga uji dhe të mbrojtjes së ambientit të punës.

2. Trepça Sh.A është e detyruar të organizojë shërbimin e mbrojtjes në punë, sipas kushteve specifike të tyre.

3. Shërbimin e mbrojtjes në punë e bën numri i nevojshëm i punonjësve me përgatitje superiore ose të lartë profesionale.

4. Punët në kontrollin e drejtpërdrejtë të zbatimit të masave të mbrojtjes në punë mund t'i kryejnë edhe punëtorët me përgatitje të mesme profesionale, të cilët kanë së paku pesë vjet përvojë pune në profesion.

5. Shërbimi i mbrojtjes në punë posaçërisht është i detyruar në zbatimin e masave të sigurisë në punë, duke përfshirë edukimin, përcjelljen e gjendjes shëndetësore dhe kontrolleve për punonjësit.

6. Për organizimin e shërbimit të mbrojtjes në punë dhe zbatimin e masave, si dhe për funksionimin e tij të rregullt e pa pengesa, përgjigjet Kryeshefi Ekzekutiv ose udhëheqësi i njësisë biznesore përkatëse.

7. Punët, respektivisht detyrat e punës në shërbimin e shpëtimit dhe të ndihmës së parë, si dhe në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri, i kryejnë punonjësit, të cilët janë të certifikuar posaçërisht për këto punë.

2. Shërbimi i shpëtimit dhe i zjarrfikësve

Neni 11

1. Trepça Sh.A. bazuar në kushtet dhe rrethanat specifike, duhet të organizojë shërbimin e shpëtimit dhe shërbimin e zjarrfikësve.
2. Punët e shërbimit të shpëtimit dhe të shërbimit të zjarrfikësve i kryejnë punonjësit të cilët janë të certifikuar dhe të trajnuar.
3. Shërbimi Shpëtimit dhe Shërbimi i Zjarrfikësve ka këto obligime:
 - 3.1. që menjëherë t'iu dalë në ndihmë punonjësve të cilët gjenden në rrezik, në raste të shpërthimit të metanit, pluhurit, zjarrit në miniera, si dhe rreziqeve të tjera në minierë dhe në vende tjera të punës; dhe
 - 3.2. të ndërmerre masa për qarkullim pa pengesë dhe mundësi të kryerjes së punëve të detyruara në hapësirat minerare ku ka prani të gazrave helmuese;

4. Punonjësit profesional për sigurinë dhe shëndetin në punë në minierë

Neni 12

1. Punët e sigurisë dhe shëndetit në punë në minierë, gjatë kërkimit dhe shfrytëzimit të lëndëve të para minerale, mund t'i kryejnë vetëm punonjësit të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj, akte tjera nënligjore dhe me Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës.
2. Punët e mbikëqyrësit në minierë mund t'i kryej punonjësi i cili ka të kryer së paku përgatitjen e mesme profesionale të drejtimit përkatës, të ketë së paku pesë vjet përvojë pune dhe të jetë i licencuar për siguri në veprimtarinë minerare.
3. Punët e kryepunëtorit në minierë mund t'i kryej inxhinieri, i cili ka të kryer nivelin bachelor të drejtimit përkatës, të ketë së paku dy vjet përvojë pune, të jetë i licencuar për siguri në veprimtarinë minerare.
4. Punët e udhëheqjes teknike në miniera nëntokësore mund t'i kryej punonjësi i cili ka të kryer fakultetin përkatës teknik me nivel master; të ketë më së paku tre vjet përvojë pune dhe të jetë i licencuar për siguri në veprimtarinë minerare.

4. Obligimet për marrjen e masave për sigurinë dhe shëndetin në punë

Neni 13

1. Trepça Sh.A. është përgjegjëse për organizimin e shërbimit për siguri në punë, për mbrojtje kundër zjarrit dhe për kërkim-shpëtim.

2. Për zbatimin e masave të mbrojtjes në punë, përgjegjës janë të gjithë të punësuarit, në kuadër të fushëveprimit të tyre të punës në pajtim me rregullat dhe masat e sigurisë dhe shëndetit në punë.

3. Punëdhënësi ka për obligim, që çdo muaj të raportojë me shkrim në Inspektoratin e Minierave, për numrin e rasteve të aksidenteve të raportuara, si dhe për aksidentet me invaliditet të përkohshëm apo të përhershëm, si dhe për analizën e kostos së shpenzimeve financiare të krijuara si pasojë e aksidenteve në punë

Neni 14

1. I punësuar i që themelon marrëdhënie pune, para së të caktohet në një vend pune duhet të informohet për zbatimin e rregullave dhe masave të mbrojtjes në punë dhe masave për mbrojtje nga zjarri, me rreziqet që mund të hasen në punë, si dhe me organizimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse në punë.

2. I punësuar i ka të drejtë të kërkojë nga personat përgjegjës për zbatimin e rregullave, që të informohet me rreziqet e punës, me ligjet dhe detyrimet në lidhje me mbrojtjen në punë dhe me kushtet e punës.

Neni 15

I punësuar i cili caktohet në një detyrë ose vend tjetër të punës, para fillimit të punës duhet të njohet me punën, rregullat dhe masat e mbrojtjes në punë, si dhe me rreziqet të cilat mund të ndodhin në këto punë e detyra të reja.

Neni 16

1. Trepça Sh.A, ka për obligim, që kushtet për siguri në punë dhe mbrojtje të shëndetit, t'iu siguroj:

1.1. punëmarrësve që kanë themeluar marrëdhënie pune;

1.2. personave që janë në aftësim profesional te punëdhënësi, të cilët nuk kanë themeluar marrëdhënie pune;

1.3. personave në rikualifikim profesional dhe trajnim;

1.4. nxënësve dhe studentëve të cilët te punëdhënësi kryejnë punë praktike;

1.5. pjesëmarrësve në punë vullnetare apo punë tjera publike, të organizuara për interes të përgjithshëm;

1.6. personave të cilët gjatë vuajtjes së dënimit, angazhohen në kryerjen e punëve në ambientet e Trepça SH.A;

1.7. personave të cilët ndodhen në ambientet e punës siç janë bashkëpunëtorët afarist, përfaqësuesit e administratës shtetërore dhe shfrytëzuesit e shërbimeve.

Neni 17

1. Sipas kësaj Rregulloreje aksident në punë me pasoja lëndimi konsiderohet :
 - 1.1. gjatë kryerjes së punës në Trepça SH.A ku është i punësuar;
 - 1.2. gjatë kryerjes së një punë tjetër ,pa ose me urdhër të punëdhënësit për arsye madhore në interes të punës,
 - 1.3. gjatë kohës së pushimit të përcaktuar nga punëdhënësi, vënien në rregull të makinerive, veglave të punës, veshmbathjeve, pastrimit të vendit të punës para ose pas mbarimit të punës,
 - 1.4. gjatë kohës së aftësimimit dhe trajnimit profesional, dhe
 - 1.5. gjatë dhënies së ndihmës së parë punonjësve të lënduar në punë ose lidhur me punën.

6. Konstatimi i aksidentit në punë

Neni 18

1. Nuk konsiderohet lëndim në punë nëse lëndimi është provokuar nga dashja apo pakujdesia ekstreme e punonjësit që nënkupton se lëndimi nuk ka ndodh në procesin e punës apo nga mjetet e punës.
2. Lëndim në punë nuk konsiderohen rastet me fatalitet, nëse pasoja nuk ka lind nga shkak i lëndimit, por nga sëmundja edhe atëherë kur rasti ndodh ne objektet e Trepça Sh.A.

Neni 19

1. Te aksidentet me lëndime të rënda ose me fatalitet, është obligim që të lajmërohet Inspektorati i Punës, Inspektorati i Xehetarisë, Policinë e Kosovës, Emergjencia dhe Kompania e sigurimeve nëse punonjësi ka sigurim.
2. Te lëndimet e personave të tretë nga mjetet e Trepça Sh.A., është e domosdoshme që të krijohet Komisioni Profesional për konstatimin e shkaqeve të ndodhjes së aksidentit.
3. Komisionin e formon Kryeshefi Ekzekutiv ose udhëheqësi i njësisë biznesore përkatëse, por mund ta formoj edhe udhëheqësi i Njësisë Biznesore me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv. Për aksidentet me invaliditet te përkohshëm dhe përhershëm dhe rastet që përfundojnë me fatalitet, Komisioni duhet të jetë ad hoc.

Neni 20

1. Hulumtimin e ngjarjes e kryen Zyrtari për siguri në punë, veçmas apo me Komision profesional te formuar nga Kryeshefi Ekzekutiv. Ne te dy rastet hartohet procesverbal me shkrim, incizimi i vendit të ngjarjes, marrja e deklaratave nga dëshmitarët dhe personeli përgjegjës si dhe vetë personelit të aksidentuar kur për këtë të krijohen kushtet.

2. Procesverbali i plotësuar me foto- incizim, në rast nevojë edhe me skicën nga vendi i ngjarjes, i dërgohet Departamentit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Kryeshefit Ekzekutiv.
3. Të dhënat nga Procesverbali i theksuar në paragrafin 1 të këtij neni, shfrytëzohen që të sigurohet një nivel më i mirë i sigurisë dhe shëndetit në punë, eliminimit të faktorëve të rrezikut, zvogëlimin e ndikimit të substancave të dëmshme kimike, përmirësimin e pajisjeve të punës dhe pajisjeve personale mbrojtëse në punë.

Neni 21

1. Fletëlëndimin e plotëson Komisioni Profesional ose Zyrtari për siguri dhe shëndet punë, në afat prej 24 orë e më shumë afat prej 48 orë për raste vikendi dhe festa.
2. Shkakun e aksidentit e përcakton Komisioni Profesional i formuar nga Kryeshefi Ekzekutiv.
3. Në rast se nuk është formuar Komisioni Profesional, shkaku e aksidentit e konstaton Zyrtari për siguri dhe shëndet në punë.
4. Shkaku i konstatuar i aksidentit shënohet në fletë lëndim. Komisioni Profesional ose Zyrtari për siguri dhe shëndet në punë me rastin e konstatimit të shkakut të lëndimit, në fletë lëndim detyrimisht konstaton se aksidenti ka ndodhë nga lëshimet eventuale të punëdhënësit, apo me fajin e punonjësit duke mos respektuar rregullat për sigurinë dhe shëndetin në punë.
5. Fletëlëndimin e nënshkruajnë :
 - 5.1. Komisioni Profesional ose Zyrtari për siguri dhe shëndet në punë në punë dhe Kryeshefi Ekzekutiv ose udhëheqësi i njësisë biznesore përkatëse.
6. Fletëlëndimi i pa nënshkruar nga Komisioni Profesional ose Zyrtari për siguri dhe shëndet në punë dhe Kryeshefi Ekzekutiv ose udhëheqësi i njësisë biznesore përkatëse nuk konsiderohet valid.
7. Fletëlëndimi i plotësuar dhe nënshkruar dërgohet te institucion shëndetësor i autorizuar me të cilin ka kontratë Trepça Sh.A.
8. Konstatimin e kohëzgjatjes së paafësisë për punë e jap mjeku kompetent.
9. Konstatimin dhe vlerësimin e shkallës së invaliditetit e jap Komisioni Mjekësor.

Neni 22

Për secilin rast të aksidentit në punë, duhet të informohet menjëherë, Zyrtari për siguri dhe shëndet në punë, udhëheqësi i njësisë biznesore dhe Kryeshefi Ekzekutiv, varësisht nga vlerësimi i fatkeqësisë dhe njoftimi bëhet shtatë ditë në javë gjatë 24 orëve.

Neni 23

Raportet e standardizuara javore dhe mujore përdoren nëpër secilën Njësi Biznesore. Ato përmbajnë hollësi për lëndimet dhe aksidentet që kanë ndodhë gjatë periudhës raportuese dhe përfshirjen e çështjeve të sigurisë të paraqitura dhe evituara. Gjithashtu, këto raporte duhet të mbarështojnë brengat kryesore në aspektin e sigurisë dhe çdo trajnim të organizuar të personelit.

7. Të drejtat dhe obligimet e Zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë

Neni 24

1. Për zbatimin dhe përparimin e sigurisë në punë dhe emergjencave Zyrtari për siguri në punë i ka këto obligime:

1.1. Analizon burimet dhe shkaqet e lëndimeve në punë dhe dëmtuesve të shëndetit dhe propozon masa për largimin dhe pengimin e tyre;

1.2. Kontrollon zbatimin e masave dhe rregullave të sigurisë në punë, shëndetit të punonjësve dhe të mbrojtjes kundër zjarrit, sipas rregullave të përcaktuara me Ligje dhe akte nënligjore, kësaj Rregulloreje dhe vendimeve të organeve kompetente nivel vendi dhe organeve të Trepça Sh.A.

1.3. Harton plane dhe studion rregullat Ligjore nga lëmi i sigurisë në punë dhe bënë me dije për obligimin e zbatimit të domosdoshëm të rregullave dhe propozon ndërrimin e rregullave sipas nevojës.

1.4. Bashkëpunon me të gjitha strukturat në Trepça Sh.A. me qëllim të organizimit, mbikëqyrjes dhe përparimit të sigurisë në punë.

1.5. Menaxhon dhe analizon statistikat e raportimeve të aksidenteve në punë, si dhe sëmundjeve profesionale dhe raporton një herë në muaj Kryeshefit Ekzekutiv dhe Departamentit për Siguri në Punë.

1.6. Mbikëqyrë dhe koordinon kontrollimet periodike të gjendjes shëndetësore të punonjësve.

1.7. Propozon hapjen e procedurës disiplinore kundër personave përgjegjës për shkeljen e rregullave dhe mospërfillje të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

1.8. Zyrtari për siguri në punë është i autorizuar të ndaloj përkohësisht punën në vendet e punës që paraqesin rrezik për punonjës dhe për pajisje, dhe për këtë e njofton Kryeshefin Ekzekutiv dhe udhëheqësin e Njesisë Biznesore.

1.9. Bashkëpunon me organe dhe me institucione të ndryshme nga kjo lëmi.

8. Obligimet e Departamentit për Siguri dhe Shëndet në Punë

Neni 25

1. Me qëllim të implementimit të masave të sigurisë në mënyrën operacionale Departamenti për Siguri dhe Shëndet në Punë ka këto obligime:

1.1. Identifikon dhe analizon burimet dhe shkaqet e aksidenteve dhe incidenteve në punë dhe dëmtuesve të shëndetit të punonjësve dhe propozon masa udhëheqësit të drejtpërdrejt apo organit kompetent për largimin dhe pengimin e tyre;

1.2. kontrollon zbatimin e masave dhe rregullave të sigurisë në punë dhe emergjencave sipas kësaj Rregulloreje dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore si dhe udhëzimeve apo instruksioneve të Kryeshefit Ekzekutiv;

1.3. bashkëpunon me të gjitha strukturat e Njësive Biznesore dhe Departamenteve përkatëse për përpilimin e raporteve ditore dhe javore ku analizohet siguria dhe shëndeti në punë;

1.4. mban evidencë për aksidente në punë, hulumton rastin e aksidentit në punë dhe i raporton Kryeshefit Ekzekutiv ose udhëheqësit të njësive biznesore përkatëse;

1.5. mbikëqyrë dhe organizon kontrollimet sistematike mjekësore të punonjësve dhe raporton mbi gjendjen shëndetësore të tyre Kryeshefit Ekzekutiv ose udhëheqësit të njësive biznesore përkatëse;

1.6. koordinon aktivitetin me qëllim të shqyrtimit dhe matjeve periodike të pajisjeve dhe mjeteve, dëmtuesve kimike - biologjik dhe mikroklimes; dhe

1.7. harton planin e kontrollimit të pajisjeve dhe stabilimenteve të punës për çdo Njësi Biznesore, me qëllim të avancimit të gjendjes së sigurisë për punonjës dhe objekteve;

Neni 26

Për zbatimin e masave dhe rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë përgjegjës është edhe çdo i punësuar në Trepça Sh.A. si dhe çdo person që për arsye të ndryshme ndodhet në ambiente dhe perimetrin e punëdhënësit. Operatorët ekonomik si dhe kontraktorët e tyre janë të obliguar tu përmbahen rregullave të sigurisë sipas kësaj Rregulloreje dhe Ligjeve në fuqi.

9. Të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësit

Neni 27

1. Punonjësi ka të drejtë dhe obligim për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe ambientit të punës.

2. Punonjësi është i obliguar t'i:

2.1. përmbahet masave të nevojshme për siguri në punë, mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës;

2.2. kujdeset për sigurinë dhe shëndetin e tij dhe të personave të tjerë të ndikuar nga veprimet e tij në punë;

2.3. shfrytëzoj në mënyrë të duhur pajisjet personale për mbrojtje në punë dhe ti i përdorë me kujdes dhe ti mban në gjendje funksionale;

3. Për pajisjet dhe aty ku mbrojtja e përhershme dhe gjithëpërfshirëse nuk është e mundur, punëmarrësi duhet menjëherë të njoftoj udhëheqësin e tij gjegjësisht Zyrtarin për siguri dhe shëndet në punë për çdo mangësi, rrezik shëndetësor, defekt ose ndonjë dukuri tjetër e cila mund të rrezikojë sigurinë dhe shëndetin e tij ose të punonjësve tjerë.

4. Punonjësi ka të drejtë ta refuzojë punën, nëse ai ka arsye të besojë se ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e tij. Nëse punëdhënësi konsideron se refuzimi i punës është i pabazuar menjëherë duhet ta lajmëroj Zyrtarin për siguri dhe shëndet në punë, e në rast nevojë edhe Inspektoratin e Punës dhe Inspektoratin e Minierave.

5. Punonjësi bashkëpunon me punëdhënësin dhe Zyrtarin për siguri dhe shëndet në punë, për tu siguruar se mjedisi i punës dhe kushtet e punës janë të sigurta dhe se masat e urdhëruara nga Inspektorati i Punës dhe Inspektorati i Minierave zbatohen nga punëdhënësi.

6. Është e drejtë e punonjësve dhe e organizatave të tyre që të konsultohen me punëdhënësit në të gjitha aspektet e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës lidhur me punën e tyre.

7. Punonjësit do të shfrytëzojnë të gjitha makinat, pajisjet, veglat, materialin punës dhe mjetet e transportit si dhe aparatet e sigurisë dhe pajisjet personale mbrojtëse në pajtim me udhëzimet specifike të prodhuesit.

8. Punonjësi ka të drejtë të sugjeroj përmirësimin e situatës së mbrojtjes dhe shëndetit në vendin e punës.

9. Punonjësi ka të drejtë të raportoi mungesat e pajisjeve personale për mbrojtje në punë dhe masat e sigurisë në vendin e punës në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes Zyrtarin për siguri dhe shëndet në punë dhe në rast nevojë dhe Inspektoratit të Punës dhe Inspektorati i Minierave, me kusht që ata të kenë baza konkrete për të besuar se masat e mbrojtjes në punë, të zbatuara nga punëdhënësi, janë të pa mjaftueshme dhe si shtesë punëdhënësi nuk e ka evituar rrezikun. Në këtë rast për këta punonjës nuk do të ketë pasojë.

10. Punonjësi para krijimit së marrëdhënies së punës ose pas mungesës së gjatë në punë duhet të njoftohet me kushtet e punës dhe rreziqeve në vend të punës, me rregullat dhe masat e mbrojtjes në punë dhe me të drejtat dhe përgjegjësitë lidhur me sigurinë në punë.

11. Punonjësi duhet vazhdimisht të perfeksionoj dhe freskoj njohuritë e tij nga lëmi i sigurisë në punë.

12. Punonjësi i cili nuk u përmbahet masave të parapara të sigurisë në punë është përgjegjës sipas parimeve të kësaj Rregulloreje dhe Rregullores për Përgjegjësi Disiplinore dhe Materiale.

Neni 28

1. Në rast rreziku të pashmangshëm për vete dhe për personat tjerë, punonjësi ka të drejt për të zbatuar kundër-masa të përshtatshme, nëse mbikëqyrësi nuk është prezent.

2. Duke pasur parasysh trajnimin që është bërë dhe mjetet teknike në dispozicion, punonjësit nuk do të kenë pasoja për akte të tilla, përveç në rastet e neglizhencës flagrante ose sabotimit të qëllimshëm.

3. Punonjësit nuk do të kenë pasoja, nëse me qëllim të aplikimit të masave për sigurinë dhe shëndetin në punë, i kryejnë obligimet e veta duke përfshirë edhe lajmërimin apo denoncimin e punonjësit i cili i shkelë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Neni 29

Udhëheqësi i drejtpërdrejt është i obliguar që ta largoj nga puna punonjësin i cili nuk i shfrytëzon mjetet personale të sigurisë në punë, me të cilat është i ngarkuar, si dhe punonjësin i cili është nën ndikim të alkoolit dhe narkotikëve.

Neni 30

1. Punonjësi është i obliguar:

1.1. të mos hyjë në minierë dhe tjetër vend pune pa mjete personale për mbrojtje në punë;

1.2. të respektoj dhe zbatoj rregullat për mbrojtje në punë;

1.3. nëse hasë lokomotivën apo mjetin tjetër transportues, detyrimisht të strehohet në strehimoren më të afërt dhe me llapën personale, ti jep shenjë vozitësit për prezencën e tij;

1.4. para fillimit të punës të verifikoj dhe të sigurohet se në vend punishte çdo gjë është në rregull;

1.5. ti përcjell dhe ti respektoj shenjat paralajmëruese;

1.6. ti respektoj rregullat me rastin e manipulimit me mjete eksplozive;

1.7. gjithmonë me veti të ketë kutinë personale sanitare;

1.8. të mos i kryej punët për të cilat nuk posedon urdhrin e punës;

1.9. të mos lëvizë nëpër vend punishte e braktisura;

1.10. të mos largohet nga makina deri sa makina është duke punuar;

Neni 31

1. Punonjësi që punon në mirëmbajtjen e makinave dhe pajisjeve është i obliguar:
 - 1.1. të gjitha makinat dhe pajisjet që ndodhën në makina ti mirëmbajë;
 - 1.2. makinat të cilat nuk i kanë mjetet mbrojtëse dhe paraqesin rrezik gjatë operimit me to, ti largoj nga procesi i punës deri në riparimin e tyre;
 - 1.3. riparimin dhe vajtjen e makinës ta bëjë vetëm kur makina ka ndaluar të punoj;
 - 1.4. pas përfundimit të riparimit dhe vajtjes së makinës pjesët mbrojtëse ti vendosë në vendin e tyre;
 - 1.5. gjatë riparimit të çdo makine tu përmbahet udhëzimeve të prodhuesit;
 - 1.6. gjatë riparimit të çdo makine ti përdorë veglat e punës adekuate, e assesi të mos punoj me vegla pune të improvizuara; dhe
 - 1.7. para fillimit të punës ti përdorë mjetet personale mbrojtëse.

Neni 32

1. Punonjësi që punon me reagensë është i obliguar të përdorë mjetet personale për mbrojtje në punë: syza mbrojtëse, rroba pune, çizme gome, mantel gome, dorëza gome dhe maskën mbrojtëse.
 - 1.2. Në vendin e deponimit, ngarkimit dhe shkarkimit të reagensëve duhet të ketë sasi të mjaftueshme të mjeteve të nevojshme për neutralizimin e reagensëve të derdhura ;
 - 1.3. Është e ndaluar të konsumohet ushqim apo lëngje dhe të tymoset duhan në vendet ku deponohen reagensët apo punohet me to, apo të merret ushqim me duar të papastrat pas punës me reagensë;
 - 1.4. Në rast të avarisë në ventilim apo mungesës së energjisë elektrike dhe shkaktohet ndërprerja e ajrosjes, e në këtë mënyrë rritet koncentrimi i gazrave, të hapen dyer dhe dritaret me qëllim të ajrosjes;
 - 1.5. Ndalohet rreptësishtë hyrja e personave të pa autorizuar në lokalet ku bëhet deponimi dhe përgatitja e reagensëve;
 - 1.6. Me rastin e lëshimit në rezervuar me qëllim të pastrimit, punonjësit janë të obliguar ti përdorin rripat e sigurisë;
 - 1.7. Pastrimin e rezervarëve mund ta bëjnë vetëm punonjësit e trajnuar për këto punë;
 - 1.8. ndalohet kryerja e remontit të tubacionit me reagensë dhe remonti i ventileve nën presion; dhe
 - 1.9. Verifikimi, pastrimi dhe remonti i rezervuarit mund të kryhet vetëm atëherë kur janë larguar të gjitha reagensat.

III. TRAJNIMI DHE AFTËSIMI NGA LËMIA E SIGURISË NË PUNË

Neni 33

1. Punëdhënësi përkujdeset që secili i punësuar të trajnohet nga siguria dhe shëndeti në punë, për vendin e tij të punës si:
 - 1.1. para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës;
 - 1.2. në rast të transferimit apo ndërrimit të vendit të punës;
 - 1.3. në rast të paraqitjes së pajisjeve të reja apo ndërrimit të pajisjeve të punës;
 - 1.4. në rast të përdorimit të teknologjisë së re;
 - 1.5. kohë pas kohe nëse është e domosdoshme.
2. Punëdhënësi përkujdeset që të punësuarit e subjektit të kontraktuar të marrin udhëzimet adekuate për sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë aktivitetit të tyre në subjektin e tij.
3. Trajnimi i referuar në paragrafin 1. të këtij neni organizohet gjatë orarit të punës.
4. Programi themelor për arsimimin dhe trajnimin nga lëmi i sigurisë dhe shëndetit në punë përpilohet nga burimet njerëzore dhe aprovohet nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Neni 34

1. Organizimi i trajnimit nga lami ja e sigurisë, shëndetit në punë dhe Emergjencave bëhet përmes personelit cili është i trajnuar dhe i licencuar për këtë lëmi ose kompanisë së licencuar.
2. Trajnimi mbahet në objektet e Trepça Sh.A, të përshtatshme për trajnim.
3. Trajnimit i nënshtrohen të gjithë punonjësit si dhe stafi menaxhues.
4. Me rastin e zëvendësimit të punonjësit udhëheqësi i drejtpërdrejt është i obliguar para fillimit të punës ta trajnoj për vendin e ri të punës.
5. Trajnimi i punonjësve për punë duhet të bëhet në atë mënyrë e cila siguron mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të tyre dhe e cila parandalon fatkeqësitë në punë.
6. Të punësuarit trajnohen ashtu që, të bëjnë përdorimin e drejtë të mjeteve të punës, në pajtim me planin emergjent dhe në raste emergjente të veprohet sipas planit për evakuim.

Neni 35

Për dhënien e ndihmës së parë duhet të jenë të aftësuar 10 % të punësuarve dhe të shpërndarë nëpër të gjitha grupet e procesit të punës dhe ndërrimeve.

Neni 36

Rregulloren, informatorët, doracakët dhe udhëzimet tjera për punën dhe organizimin e dhënies së ndihmës së parë, dhe trajnimet nga lami ja e sigurisë, shëndetit në punë dhe emergjencave i përgatitë dhe i shpërndan Sektori i burimeve njerëzore.

Neni 37

Për vendet e punës ku kërkohet aftësi e posaçme profesionale punonjësi duhet të ketë certifikatë të posaçme përkatëse për aftësim adekuat.

IV. MBROJTJA E TË RINJËVE, GRAVE DHE PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 38

Punëmarrësit deri në moshën 18 vjeçare, gratë shtatzëna, dhe personat me aftësi të kufizuara, nuk mund të punojnë në punë të cilat për nga natyra apo rrethanat nën të cilat kryhen, mund ta dëmtojnë sigurinë apo shëndetin e tyre.

V. FURNIZIMI, SHFRYTËZIMI, KONTROLLIMI I KOHËPASKOHSHËM I MJETEVE, PAJIMEVE DHE I VEGLAVE PËR PUNË

Neni 39

Mjetet për punë, pajisjet dhe veglat, i furnizon shërbimi i autorizuar dhe gjatë furnizimit duhet të ketë kujdes që këto mjete dhe pajisje të posedojnë a testet dhe certifikatat me të cilat vërtetohet cilësia e tyre nga aspekti i sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Neni 40

1. Punëdhënësi duhet të mbajë:

1.1. Certifikatat teknike të cilat qartë specifikojnë aplikimin e rregullave të sigurisë në punë, shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, për lokalet, pjesët e lokaleve të shfrytëzuara si dhoma pune dhe dhomave ndihmëse në përdorim.

1.2. Udhëzimet për përdorimin e gjithë makinerisë dhe të pajisjeve në procesin e punës, dhe masat e sigurisë .

1.3. Certifikatat të cilat vërtetojnë se instalimet janë në rregull dhe tregojnë qartë karakteristikat e makinës në përdorim, në pajtim me standardet Evropiane – evidencën për programet për trajnimin e punëtorëve për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurtë.

1.4. Evidencën për kontrollimin paraprak dhe periodik mjekësor të punonjësve të

caktuar në punë të cilat kryhen në kushte të veçanta të punës.

1.5. Evidencën për substancat e dëmshme të cilat gjatë procesit të punës lirohen;

1.6. Evidencën për aksidentet në punë, rastet e lëndimeve, lëndimeve me fatalitet, lëndimeve kolektive dhe rastet e sëmundjeve profesionale;

1.7. Evidencën për rezultatet e të gjitha vlerësimeve për rreziqet, masave të ndërmarra për ti eliminuar rreziqet e tilla dhe rezultatet e kontrollimeve mbi efektet e marrjes së masave;

1.8. Evidencën për ndryshimet në proceset teknologjike të cilat rrezikojnë ose mund të paraqesin rrezik për sigurinë dhe shëndetin në punë , mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës. Materialet (llamarinat, çeliqet, tubat, vajrat, reagens at dhe kimik alet, pajisjet etj.) për procesin e prodhimit duhet të kenë atestë dhe certifikata për cilësi sipas standardeve evropiane.

Neni 41

1. Me qëllim të sigurimit të kushteve profesionale të punës me mjetet dhe pajisjet për punë Njësitë Afariste dhe njësitë tjera të Trepça SH.A, janë të obliguara që në afatet e parapara të bëjnë verifikimin dhe kontrollimin e rregullsisë së mjeteve dhe pajisjeve të punës.

2. Afatet kohore të shqyrtimeve dhe testimeve duhet të respektohen sipas rekomandimeve teknike të prodhuesve.

Neni 42

Punonjësit gjatë përdorimit të: mjeteve, pajisjeve dhe veglave për punë, janë të obliguar që rreptësishtë të respektojnë udhëzimet dhe normat e rekomanduara nga prodhuesi si dhe rregullat e sigurisë në punë.

Neni 43

1. Të gjitha aparatet dhe pajisjet, që punojnë me energji elektrike, avull, gaz dhe me ujë duhet të jenë në rregull dhe të harmonizuara me rregullat teknike në fuqi nga kjo lëmi.

2. Aparatet elektrike duhet të jenë të lidhura me tokëzim.

VI. MASAT E SIGURISË NË OBJEKTE

Neni 44

Gjatë projektimit dhe ndërtimit të objekteve të reja investuese, projektuesi është i obliguar të ju përbëhet rregullave dhe standardeve nga siguria në punë.

Neni 45

1. Në vendet e punës që gjenden në ambiente të mbyllura duhet të jetë siguruar sasia e duhur e ajrit të freskët, duke marrë parasysh aktivitetin e punës.
2. Nëse shfrytëzohen pajisjet për klimatizim dhe ventilim, nuk lejohet që punonjësve tu shkaktoj shqetësim për shkak të rritjes së shpejtësisë së rrymave të ajrit.

Neni 46

1. Për të punësuarit, duhet të jetë numër i mjaftueshëm i banjave, dusheve dhe lavamanëve, në rastet kur këtë e kërkon natyra e punës, e sidomos për punonjësit që janë të ekspozuar spërkatës apo përlyerjes së rrobave, pluhurit, djersitjes si dhe për punonjësit që punojnë me materiale që mund të jenë helmuese apo që ndizen lehtë.
2. Banjat me dush, duhet të jenë të përshtatshme që çdo i punësuar mund të pastrohet pa kufizim dhe të kenë ujë të ngrohtë dhe të ftohtë.
3. Numri i dusheve në banja duhet të jete në harmoni me numrin e punonjësve që kanë nevojë për pastrim.
4. Lavamanët duhen të jenë të pajisur me mjete të mjaftueshme për pastrim, dezinfektim dhe larje të duarve.
5. Nëse dhomat me dushe e lavaman janë të ndara nga dhoma e gardërobës, atëherë duhet të jenë drejtpërdrejt të ndërlidhura.

Neni 47

Në afërsi të vendeve të punës, të vendeve për qëndrim, gardërobave dhe dhomave me dushe duhet të jenë siguruar numër i mjaftueshëm i toaleteve me lavaman për meshkuj dhe femra.

Neni 48

1. Varësisht nga numri i vendeve të punës, lloji i punëve dhe rasteve të lëndimit në vend të punës, duhet të sigurohen një apo më shumë dhoma për dhënien e ndihmës së pare të pajisura me mjete dhe medikamente adekuate, lese të përshtatshme për bartjen e të lënduarve dhe të jenë të shënuara me shenja të dukshme.
2. Adresa dhe numri i telefonit të institucionit më të afërm shëndetësor duhet të jenë të vendosura në vend të dukshëm.

Neni 49

1. Vendet për ngarkim-shkarkim duhet:
 - 1.1. të jenë adekuate me dimensionet dhe peshat e barrëve me të cilat manipulohet;
 - 1.2. të kenë së paku një dalje, e nëse kushtet teknike e lejojnë duhet të ketë dalje në të dy anët;

- 1.3. të jenë të siguruar që të mos vij deri të rënja e punonjësve;
- 1.4. të kenë strukturë dhe stabilitet që i përgjigjet de stinimit;
- 1.5. rrugët të jenë të pastruara nga akulli, bora, dheu, rëra dhe zhavorri;
- 1.6. distanca e automjeteve të radhitura për ngarkim-shkarkim të mos jetë më e vogël se dy metra;
- 1.7. shpejtësia e automjeteve të mos jetë më e madhe se dhjetë kilometra në orë, ndërsa në depot e mbyllura të mos jetë më e madhe se pesë kilometra në orë;
- 1.8. gjatë punës natën, duhet të jenë të ndriçuara mjaftueshëm;
- 1.9. para fillimit të punës të verifikohet rregullsia e automjetit transportues;
- 1.10. me rastin e ngarkimit dhe shkarkimit të ngarkesave, të sigurohet automjeti transportues të mos vetëlëvizë;
- 1.11. pas kryerjes së ngarkesës në automjetin transportues, të sigurohet ngarkesa është vendosë si duhet dhe anësoret janë mbyllë në mënyrë të rregullt;
- 1.12. gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të ngarkesës, riparimit dhe furnizimit me derivate të automjetit transportues, motori gjithmonë të jetë i fikur;
- 1.13. riparimi i automjetit transportues të bëhet vetëm në servisën e autorizuar;
- 1.14. gjatë transportimit të mjeteve eksplozive dhe mjeteve që ndizen lehtë, të mos konsumohet duhani;
- 1.15. kur vozitet në perimetrin e objekteve të Trepça Sh.A, shpejtësia e lëvizjes të mos jetë mbi 10 km në orë dhe të respektoj rregullat e vozitjes si në komunikacionin publik.

Neni 50

1. Vendet e punës duhet të jenë të ndriçuara me dritë të mjaftueshme natyrore dhe në rast nevojë të jenë të pajisura me burime të ndriçimit artificial, por gjithsesi të kenë të siguruar dritë të mjaftueshme për punë të sigurt.
2. Instalimet për ndriçim të vendeve të punës duhet të jenë të vendosura në atë mënyrë, që mos të paraqesin rrezik për të punësuarit dhe kjo të mos varet nga lloji i ndriçimit.
3. Vendet e punës në të cilat punonjësit mund të jenë të rrezikuar në rast të mungesës së dritës artificiale, duhet të jenë të pajisura me mjete ndriçuese alternative, me fuqi adekuate të ndriçimit;
4. Ngjyra e ndriçimit artificial nduk duhet të ndikoj në identifikimin e shenjave për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Neni 51

1. Sistemi i ajrosjes artificiale duhet të jetë në gjendje të rregullt.
2. Me rastin e shfrytëzimit të aklimatizimit dhe ventilimit, kjo nuk duhet të shkaktoj pakënaqësi te punonjësit për shkak të shpejtësisë së rrymimit të ajrit.

3. Pluhuri dhe papastërtitë tjera në pajisjet e klimatizimit dhe ventilimit duhet të mënjahohen rregullisht.

Neni 52

Të punësuarve që punojnë me substanca të rrezikshme ose në kushte shumë të ndyra, duhet të u sigurohen mjete për pastrimin e rrobave të punës dhe mjete për mbajtje të higjienës personale.

Neni 53

Zhurma, dridhja dhe drita duhet të matën dhe kontrollohen nga institutet e autorizuar përkatëse apo kompanitë e licencuara. Niveli i zhurmës dhe dridhjes, duhet të rregullohet dhe të sillen në kufi të lejuar në pajtim me standardet evropiane.

Neni 54

Të gjitha pajisjet elektrike, duhet ta kenë tiketën, në të cilën shënohen karakteristikat e tyre me simbolin CE. Instalimet e rrymës duhet bëhen në pajtim me standardet evropiane.

Neni 55

Vendi i punës duhet të jetë i pajisur me mjete përkatëse kundër zjarrit dhe me kuti sanitare për dhënien e ndihmës së parë, në pajtim me Planin e Emergjencave.

Neni 56

Në raste emergjente, daljet duhet të jenë qartë të shënuara dhe duhet ta kenë ndriçimin emergjent.

Neni 57

Rruga kah dalja emergjente duhet të mos ketë pengesa, si dhe dyert e daljes emergjente nuk guxojnë të jenë të mbyllura me çelës.

Neni 58

Të gjitha Njësitë Biznesore dhe departamentet tjera të Trepça Sh.A, janë të obliguara të hartojnë Planin Emergjent për evakuimin e njerëzve dhe pajisjeve lëvizëse në situata të jashtëzakonshme.

Neni 59

1. Niveli i ndotjes së ajrit nga pluhuri, gazrat dhe rrezatimi jonizues dhe jo jonizues, duhet të matet dhe kontrollohet në institucionet e autorizuar përkatëse apo kompanitë e licencuara .
2. Pluhuri dhe gazrat duhet të pastrohen përmes ventilimit dhe formave tjera, në atë mënyrë që të parandalojnë kon centrimet që dëmtojnë shëndetin ose pengojnë pamjen kon formë standardeve evropiane.
3. Trepça Sh.A është e obliguar që të kryej matje periodike të mikroklimës duke përfshirë edhe rrezatimet jonizuese dhe jo jonizuese në vendet e punës të parapara me rregullativë ligjore.
4. Në ambientet e mbyllura të punës, ndalohet pirja e duhanit.

5. Punëdhënësi është i obliguar të caktoj hapësirat ku është e lejuar pirja e duhanit, dhe të siguroj ato vende nga aspekti i mbrojtjes kundër zjarrit.

VII.MASAT E SIGURISË GJATË PËRDORIMIT TË MJETEVE TË PUNËS

Neni 60

1. Punëdhënësi është i obliguar që mjetet e punës të jenë në gjendje të rregullt, të përshtatshme dhe gjatë punës të jenë në funksion të sigurisë dhe shëndetit në punë të punonjësve.
2. Punëdhënësi është i obliguar, që me rastin e furnizimit me mjete të punës të ketë parasysh, kushtet e punës, shkallen e rrezikshmërisë dhe rrethanat tjera që kanë të bëjnë me ambientin dhe vendin e punës.
3. Nëse mjetet e punës nuk ofrojnë siguri të plotë, punëdhënësi është obliguar të ndërmerre masa plotësuese për sigurinë dhe shëndetin e punonjësve.

Neni 61

1. Me qëllim të krijimit të kushteve për siguri dhe shëndet në punë, punëdhënësi duhet të siguroj:
 - 1.1. kontrollimin e herëpashershëm të mjeteve të punës dhe në rast nevojë edhe të angazhoj ekspert të kësaj lëmie;
 - 1.2. kontrollime të posaçme nga ekspert kompetent kur paraqiten rrethana të jashtëzakonshme të cilat mund të dëmtojnë mjetet e punës;
 - 1.3. për kontrollimin e mjeteve të punës, punëdhënësi mbanë evidence, dhe në rast nevojë ia prezanton Inspektorit të Xehetarisë, Inspektoratit të Punës dhe organeve tjera kompetente; dhe
 - 1.4. nëse mjetet e punës, për një kohë kanë qëndruar jashtë lokaleve të punëdhënësit, detyrimisht duhet të kontrollohen dhe testohen para përdorimit.

Neni 62

1. Punëdhënësi duhet të siguroj punonjësve informata adekuate, në rast nevojë duke përfshirë edhe informata me shkrim për mënyrën e drejtë të përdorimit të mjeteve të punës.

Neni 63

1. Mjetet e punës duhet të kenë pajisjet për ndalim të sigurt dhe të plotë.
2. Çdo mjet i punës duhet të ketë pajisjet për ndalim të sigurt të një pjese apo të tërë pajisjes së punës.

3. Varësisht nga rrezikshmëria, mjetet e punës duhet të kenë pajisjet për ndalim të sigurt edhe në rastet ekstreme.
4. Pajisjet për ndalim duhet të kenë përparësi nga pajisjet për aktivizimin e mjetit për punë.
5. Nëse mjetet e punës paraqesin rrezik nga rënja apo hedhja e sendeve, duhet të jenë me pajisje të veçanta mbrojtëse.
6. Nëse mjetet e punës paraqesin rrezik nga lëshimi i gazit, avullit, lëngjeve apo pluhurit, duhet në burim të vendosen pajisjet për mbledhjen apo largimin e tyre.
7. Në rast të ndalimit së punuari të mjeteve të punës, duhet shkyçur nga furnizimi me energji elektrike;
8. Pjesët e mjeteve të punës gjithmonë duhet të jenë të sforcuara.
9. Nëse ekziston rreziku nga pëlçitja apo thyerja e pjesëve të mjeteve të punës, që mund të shkaktojnë rrezik për sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve, duhet të ndermirën masa shtesë të sigurisë; dhe
10. Nëse ekziston rreziku nga kontakti me pjesët e lëvizshme të mjeteve të punës, që mund të shkaktojnë lëndime, këto pjesë duhet të kenë pajisje mbrojtëse shtesë;

Neni 64

1. Ambienti dhe vendi për mirëmbajtjen e mjeteve të punës, duhet të jenë të ndriçuar mjaftueshëm, varësisht nga punët të cilat kryhen.
2. Nëse pjesët e mjeteve të punës janë me temperatura shumë të larta apo me temperatura shumë të ulëta, duhet të ndermirën masa adekuate që punonjësi mos ketë kontakt me to;
3. Shenjat parandaluese në mjetet e punës duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe lehtë të dukshme;
4. Mjetet e punës duhet të përdoren ekskluzivisht vetëm për ato punë për çka janë destinuar.
5. Punët për mirëmbajtje në mjetet e punës mund të kryhen vetëm kur janë në gjendje mosveprimi. Nëse kjo është e pamundur, duhet ndërmarrë masa shtesë për siguri në punë.

Neni 65

Është e ndaluar shfrytëzimi i mjeteve të punës që lëvizin me motor me djegie të brendshme në hapësirat e mbyllura derisa nuk sigurohet sasi e mjaftueshme e ajrit për punë të sigurt të punonjësve.

VIII. MASAT E SIGURISË GJATË TRANSPORTIT TË PUNONJËSVE

Neni 66

Punëdhënësi është i obliguar në të gjitha rrugët e brendshme në perimetrin e veprimit, të vendos shenja për përkufizimin e shpejtësisë të lëvizjes së mjeteve motorike dhe ti sigurojë të gjitha shenjat e komunikacionit.

Neni 66

1. Rreptësishtë është e ndaluar që punonjësit të barten me mjete të papërshtatshme dhe të rrezikshme për jetën e tyre siç janë: autovinçi, piru njeri, luga-ngarkuese e të ngjashëm me këto.
2. Rreptësishtë ndalohet bartja e punonjësve me mjete transportuese me të cilat transportohen mjete ndezëse të eksplozivit dhe me tretje helmuese.

Neni 67

1. Punonjësve të autovinçave, ekskavatorëve hidraulik dhe makinave tjera të rënda u ndalohet puna me makinat e tyre nën largpërçues dhe lokacione tjera ku mund të rrezikohet jeta apo pajisja gjatë punës.
2. Ndalohet qëndrimi apo kalimi i punonjësve dhe personave tjerë nën peshat e ngritura të vinçit apo piru njërit.

Neni 68

Me rastin e transportimit të ma terjeve që ndezën lehtë, dhe helmues duhet aplikuar masat e parapara me ligj dhe rregulla të transportit për këtë veprimtari.

Neni 69

1. Punonjësit joprofesional dhe të paautorizuar nuk guxojnë të punojnë dhe operojnë me pajime elektrike.
2. Pajimet elektrike duhet të jenë të siguruara dhe të shënuara me shenja adekuate standarde.
3. Në lokalet ku janë të vendosura pajisjet elektrike të tensionit të lartë, nuk lejohet qasja e punëtorëve joprofesional dhe të pa autorizuar. Këto lokale duhet të mbahen të mbyllura dhe të siguruara nga qasja e punonjësve të pa autorizuar.

Neni 70

1. Kur duhet të kryhen punë në pajisje elektrike, kurse ekziston mundësia e prekjes së rastësishme në pjesët nën tension apo rreziku nga fusha elektrike, tensioni se pari duhet të çkyçet, të bëhet tokëzimi dhe të përdorën të gjitha masat dhe mjetet e sigurisë në punë të cilat janë të parapara me procedura e shkyçjes dhe kyçjes, rregullat teknike dhe ato të sigurisë në punë.

2. Të gjitha objektet duhet të jenë të mbrojtura me rrufepritës.

Neni 71

1. Rreptësishtë ndalohet heqja e shenjave të sigurisë, keqpërdorimi dhe dëmtimi i tyre. Shenjat mbrojtëse mund të hiqen vetëm atëherë kur të aftësohet mjeti ose kur ai të zëvendësohet.

2. Pas mbarimit të punës, sipas paragrafit paraprak punonjësi i cili e ka larguar shenjen e sigurisë është i obliguar që atë ta rikthejë.

IX. USHQIMI I PUNONJËSVE

Neni 72

Të punësuarve duhet ofruar vende për ngrënie, me lagështi të lejuar, të pastruar, me nxehtësi të mjaftueshme, të ventiluar dhe të pa ndikuar nga atmosfera e dëmshme. Vendet e ngrënies duhet të pajisen me inventar të përshtatshëm.

Neni 73

Punëdhënësi është i obliguar të siguroi sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm për të punonjësit sipas natyrës së punës dhe vendit të punës.

Neni 74

Zyrtari i sigurisë në punë në bashkëpunim me inspektorin sanitar kujdeset edhe për kushtet higjienike në objektet ku ushqehen punonjësit.

Neni 75

Analiza e ujit të pijshëm dhe nevojat sanitare duhet të kryhen sipas rregullave ligjore. Lokalet ku përgatitet ushqimi dhe ndihmëse duhet të jenë në harmoni me kushtet higjienike dhe sanitare të parapara me rregullat në fuqi.

X. MBROJTJA SHËNDETSORE

Neni 76

1. Me mbrojtje shëndetësore të punonjësve nënkuptohet:

- 1.1. kontrolli shëndetësor i punonjësit para lidhjes së kontratës së punës,
- 1.2. kontrollimi sistematik shëndetësor,
- 1.3. kontrolli specialistik, dhe
- 1.4. kontrollimet shëndetësore të rastit.

Neni 77

1. Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve ose sëmundjes së papritur, punëmarrësit t'i sigurojë:

- 1.1. dhënien e ndihmës së parë,
- 1.2. të siguroj evakuimin e të punësuarit-lënduarit në mënyrë adekuate,
- 1.3. siguroj dhe organizoj kontakte me shërbimin përkatës,
- 1.4. dhënien e ndihmës së parë,
- 1.5. kujdesin urgjent mjekësor-emërgjent,
- 1.6. mbrojtjen kundër zjarrit,
- 1.7. aftësimin e numrit të caktuar të punonjësve për dhënien e ndihmës së parë,
- 1.8. shpëtimin dhe evakuimin e punëmarrësve në rast të rrezikut të mundshëm.

Neni 78

1. Para lidhjes së kontratës së punës çdo punonjës është i obliguar që ti nënshtrohet kontrollit mjekësor sipas udhëzimit të Departamentit të burimeve njerëzore dhe trajnimit nga lëmi i sigurisë dhe shëndetit në punë dhe emergjencave.
2. Çdo punonjës është i obliguar ti nënshtrohet kontrollit mjekësor dhe sistematik i cili organizohet sipas renditjes së njësive afariste dhe njësive tjera në Trepça SH.A sipas afateve të përcaktuara me Ligj.
3. Ligji përcakton afatet e kontrollimit mjekësor për punët me kushte të veçanta së paku një herë në vit dhe sa herë që paraqitet nevoja varësisht prej gjendjes shëndetësore e punonjësit.
4. Të gjithë punësuarit tjerë duhet të kryejnë së paku një kontroll mjekësor brenda 3 viteve.
5. Mosparaqitja për vizitë të kontrollit sistematik apo specialistik është shkelje e rëndë e detyrave të punës.

Neni 79

Dhuresit e gjakut, gjatë vitit kalendarik kanë të drejtë pushimi me pagesë, një ditë pune për çdo dhenje vullnetare të gjakut.

XI. EVIDENCA LIDHUR ME AKSIDENTET NË PUNË

Neni 80

1. Evidenca përfshinë të dhënat për punonjësit të caktuar për punë në kushte të veçanta punë dhe afatet kohore gjatë të cilave punonjësit duhet të dërgohen sërish për kontrolle mjekësore.
2. Evidentimi i punonjësve të caktuar për punë në kushte të veçanta pune përfshinë:
 - 2.1. emri, mbiemri, vendi dhe data e lindjes;
 - 2.2. titullin e vendit të punës dhe detyrat për të cilat i janë caktuar punonjësit;
 - 2.3. të dhëna mbi llojet dhe masën e rreziqeve që rezultojnë nga punët dhe detyrat në kushte të veçanta të punës në të cilat punonjësi është i caktuar;
 - 2.4. data kurë punonjësi ka filluar të realizojë punët në kushte të veçanta të punës;
 - 2.5. të dhënat mbi kushtet e veçanta lidhur me moshën, gjininë, aftësitë profesionale, shëndetin, gjendjen fizike ose mendore dhe psikologjike që punonjësi duhet ti përmbush;
 - 2.6. shenjën dhe datën e dokumentit- certifikatën e aftësisë për pune, mbi bazën e të cilës është verifikuar aftësia e punonjësit për të kryer punë në kushte të veçanta të punës për të cilat është caktuar;
 - 2.7. afatet kohore për kontroll mjekësore të punonjësve, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-161 për Siguri dhe Shëndetin në Punë, dhe
 - 2.8. emri dhe mbiemri i punonjësit i cili i ka vendosur të dhënat në regjistër për evidentim.

Neni 81

1. Për çdo punonjës që lëndohet në punë evidentohen dhe regjistrohen këto të dhëna:
 - 1.1. emri, mbiemri, data e lindjes, vendlindja dhe gjinia;
 - 1.2. numri i regjistrimit të punonjësve;
 - 1.3. profesioni dhe përgatitja shkollore;
 - 1.4. përgatitja profesionale për realizimin e punëve dhe detyrave të punës;
 - 1.5. përvoja e punës në njësinë biznes orë ku punon;
 - 1.6. veprimtaria e primare e njësisë biznesore;
 - 1.7. vendi i punës;
 - 1.8. orari i punës në orë, ditët e punës në javë;
 - 1.9. të dhënat se a është konstatuar se punonjësi në vendin e punës është i rrezikuar;
 - 1.10. konstatimi se a janë përdor pajisjet dhe mjetet personale mbrojtëse;
 - 1.11. konstatimi se a janë zbatuar rregullat bazë dhe të veçanta për sigurinë në punë;
 - 1.12. puna që punonjësi ishte duke e realizuar kur u lëndua;
 - 1.13. sa orë ka punuar punonjësi në ditën para lëndimit;
 - 1.14. të dhënat se a është lënduar punonjësi në punë edhe më parë dhe sa herë;

- 1.15. të dhënat se a ka ndodhur lëndim i tillë ose i ngjashëm edhe më parë në të njëjtin vend të punës ose gjatë realizimit të punës së njëjtë;
- 1.16. datën, ditën e javës dhe orën kur punonjësi është lënduar;
- 1.17. punonjësi a është lënduar gjatë realizimit të detyrave të punës në vendin e punës, në rrugë për në vendin e punës dhe anasjelltas, ose diku tjetër;
- 1.18. numri i personave të lënduar në total së bashku me lëndimet me fatalitet;
- 1.19. sa persona kanë vdekur në vendin e punës, ose në rrugë drejt institucionit shëndetësor;
- 1.20. sa persona kanë pësuar lëndime të rënda;
- 1.21. sa persona janë lënduar lehtë;
- 1.22. burimi i lëndimit;
- 1.23. mënyra dhe shkak i lëndimit;
- 1.24. lloji i lëndimit dhe pjesa e lënduar e trupit;
- 1.25. pjesa e dëmtuar e trupit; dhe
- 1.26. kohëzgjatja e paaftësisë së punonjësit për punë.

2. Për çdo punonjës që sëmuret nga sëmundjet profesionale në punë, evidentohen dhe regjistrohen të dhënat e caktuara nga nën-paragrafët;

- 2.1. deri te nën paragrafi 1.11. i këtij neni, si dhe të dhënat e tjera si:
- 2.2. emri i institucionit shëndetësor i cili e ka përcaktuar sëmundjen profesionale dhe datën kur është konstatuar se punonjësi është sëmur;
- 2.3. emërtimi i sëmundjes profesionale;
- 2.4. emërtimi i shkaktarit të sëmundjes dhe a ka qenë i caktuar punonjësi në punë me kushte të veçanta pune;
- 2.5. kontrollet e nevojshme mjekësore të punonjësve, për kryerjen e punëve, sipas Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.
- 2.6. gjatë kontrollimit mjekësor a janë propozuar masat shëndetësore si:
 - 2.6.1. ndryshimi i vendit të punës;
 - 2.6.2. dërgimi për shërim;
 - 2.6.3. orari i shkurtuar i punës;
- 2.7. sa kohë punonjësi ka kaluar duke realizuar punët dhe detyrat e punës në vendin e punës nga momenti i konstatimit të sëmundjes profesionale;
- 2.8. konstatimi se, a është realizuar shqyrtimi i mjedisit të punës brenda kohës dhe ndikimi i faktorëve që lidhen me mjedisin e punës;
- 2.9. në bazë të rezultateve të marra nga shqyrtimi, a janë propozuar masat për sanim;
- 2.10. konstatimi se, a janë rezultatet e rishikimit të mjedisit të punës në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregulloret dhe standardet në fuqi.
- 2.11. cilat kanë qenë elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës;
- 2.12. a ka qenë në atë vend të punës edhe më parë i regjistruar ndonjë rast i sëmundjeve profesionale të punonjësve të sëmurë në dy vitet e fundit; dhe
- 2.13. kohëzgjatja e paaftësisë së punonjësit për punë.

3. Në regjistrin për evidencë të punonjësve që janë lënduar dhe sëmurë në punë të dhënat regjistrohen jo më vonë se tri ditë nga dita kur punonjësi është lënduar ose sëmurë në punë, kurse të dhënat mbi paaftësinë e punonjësve për punë regjistrohen brenda tri ditëve nga data e marrjes së dokumentacionit mjekësor dhe dokumenteve përkatës me të cilat vërtetohen faktet për sëmundjen.
4. Saktësia e të dhënave të evidentuara dhe të regjistruara verifikohen pas nënshkrimit të personit të autorizuar.
5. Të dhënat për punonjësit e lënduar dhe të sëmurë në punë evidentohen dhe regjistrohen si në vijim:
 - 5.1. të dhënat e përcaktuara nga nën paragrafi 1.1. deri te nën-paragrafi 1.9. i këtij neni vërtetohen në bazë të dokumentacionit përkatës;
 - 5.2. të dhënat e përcaktuara nga nën paragrafi 1.10. deri te nën paragrafi 1.23 i këtij neni vërtetohen në bazë të procesverbalit të raportit mbi inspektimin e lëndimeve në punë;
 - 5.3. të dhënat e përcaktuara nga nën paragrafi 1.24 deri te nën paragrafi 1.26. të këtij neni, si dhe të dhënat nga paragrafi 2. i këtij neni, vërtetohen në bazë të dokumentacionit përkatës mjekësor dhe dokumenteve përkatëse.
6. Të dhënat për punëtorët që janë lënduar ose sëmur në punë sipas këtij neni evidentohen dhe regjistrohen në formën e kërkuar në mënyrë përshkruese.
7. Për punonjësin e paaftë për punë, nga data 31 dhjetor të vitit aktual, shënohet numri i orëve të humbura dhe data e kthimit në punë. Koha e paaftësisë për punë regjistrohet në regjistrat për vitin e ardhshëm kalendarik.

XII. BURIMI I LËNDIMIT NË PUNË

Neni 82

1. Burime të lëndimit të punonjësve në punë konsiderohen lëndimet nga mjetet e punës dhe burimet tjera varësisht nga procesi i punës, të cilat duhet të evidentohen:
 - 1.1. për objektet, aparatet dhe pajisjet, gjatë evidentimit të tyre regjistrohet emri i objektit, aparatit dhe i pajisjes, numri i inventarit ose identiteti i tij;
 - 1.2. objektet energjetike për prodhim, bartje dhe transmetim të energjisë elektrike, termike dhe të llojeve të tjera të energjisë, stacionet e kompresorëve, dhe enët nën presion;
 - 1.3. objektet teknologjike për inxhinieri, makineritë dhe pajisjet e transportit, makinerive dhe e aparateve elektrike, materialeve ndërtimore, gurit, zhavorrit, rërës, pajisjeve minerare;
 - 1.4. objektet për procese kimike-teknologjike të produkteve të naftës, dhe lëndët e para jo metalore;

- 1.5. objektet dhe instalimet për magazinimin dhe bartjen e materialeve dhe substancave të të gjitha llojeve, transportuesit e lëndëve të ngurta, lëngëta dhe të gazta me instalimet dhe pajisjet e tyre përkatëse;
 - 1.6. makinat vetëlëvizëse motorët me djegie të brendshme, motorët me avull, dhe turbinat me gaz;
 - 1.7. bartësit e energjisë, reduktorët, transmetimet;
 - 1.8. pajisjet, aparatet dhe makinat për përpunim mekanik dhe termik presat, tornot, shpueset, prerëset, mullinjftë, makina për thyerje-bluarje, sharat, tharëset;
 - 1.9. makineritë dhe pajisjet për përpunimin e drurit dhe materialeve të ngjashme;
 - 1.10. për mjetet e transportit gjatë evidentimit të tyre duhet të regjistrohet emri i mjetit të transportit, numri i inventarizimit, numri i regjistrimit ose numri i fabrikës, qëllimi dhe identiteti;
 - 1.11. mjetet transportuese horizontale të ngarkesave, vinçat, pirunierët, rimorkio elektrike, traktorët, si dhe të gjitha pajisjet speciale që përdoren në miniera;
 - 1.12. për mjetet dhe pajisjet gjatë evidentimit duhet të regjistrohet emri i mjetit pajisjes, shenja identifikuese apo numri dhe qëllimi i tyre;
 - 1.13. bombolat për gazra nën presion oksigjen, acetilen, butan, argon, dyoksid karboni, gazra mjekësore dhe të ngjashme;
 - 1.14. mjetet për bartje të ngarkesave vertikale vinçat elektrik dhe manual të gjitha llojet e çikrikëve, dhe të ngjashme;
 - 1.15. ashensorët për njerëz dhe të mallrave në hapësirat punuese, punëtoritë dhe punishte-minierë;
 - 1.16. për burimet që varen nga procesi i punës, duhet të evidentohen dhe të regjistrohet emri i burimit dhe vendi i ngjarjes;
 - 1.17. substancat shpërthyes;
 - 1.18. pluhuri dhe gazrat;
 - 1.19. materiet e dëmshme kimike; dhe
 - 1.20. rrezatimi jonizues me burime të rrezatimit, substancat radioaktive, dhe mbetjet radioaktive.
2. Për mjedisin e punës evidentohet dhe regjistrohet, lloji i mjedisit të punës, vendi më i përafërt ku ka ndodhur lëndimi i punonjësit në:
 - 2.1. objektet e destinuar për punë me hapësirat e instalimet dhe pajisjet e ndërlidhura;
 - 2.2. hapësirat dhe sipërfaqet për lëvizjen e personave në punë;
 - 2.3. hapësirat ndihmëse me instalime dhe pajisjet e tyre;

- 2.4 fatkeqësitë natyrore;
 - 2.5. zjarri, vërshimet;
 - 2.6. faktorët e mjedisit të punës, ndriçimi, ajrosja, temperatura, zhurma.
3. Burime të tjera varësisht nga mjedisi i punës si:
- 3.1. punonjësit tjerë pjesëmarrës në procesin e punës;
 - 3.2. forca madhore;
 - 3.3. veprimtari të paligjshme të palëve të treta;
 - 3.4. pjesëmarrës tjerë që paraqiten si burim i lëndimit të punonjësit;
4. Si e dhënë tjetër, regjistrohet mënyra dhe shkaku i lëndimit, të cilat duhet të regjistrohen përfshijnë rastet si:
- 4.1. rënia e punonjësit nga lartësia ose në thellësi apo rënia e punonjësit në të njëjtin rrafsh;
 - 4.2. rënia e ndonjë objekti mbi punonjësin, për shkak të rrokullisjes, rrëshqitjes, shembjes gjatë trajtimit të lëndës;
 - 4.3. përplasja e punonjësit me objekte të lëvizshme dhe të palëvizshme, goditjet nga objektet ku ecin punonjësit, prerjet, therjet;
 - 4.4. zënia e trupit të punonjësit ndërmjet objekteve të lëvizshme dhe të palëvizshme, pajisjeve, makinave, aparateve dhe veglave, ndrydhjet, shkeljet e punonjësit;
 - 4.5. sforcim i tepruar trupor ose lëvizjet e gabuara të punonjësit gjatë ngritjes së peshave, shtyrjes apo tërheqjes së objekteve, përdorimit dhe trajtimit mjeteve të punës, gjatë ngjitjes;
 - 4.6. ekspozimi i punonjësit nxehtësisë, ftohtit, lagështisë, presionit atmosferik të ngritur ose të zvogëluar, zhurmës, vibrimeve ose tronditjeve, kushteve klimaterike të pafavorshme;
 - 4.7. kontaktet e punonjësve me objekte nën tension të rrymës elektrike; dhe
 - 4.8. ndikimi i mundshëm në punonjës i materieve të dëmshme ose rrezatimit efektet e dëmshme të pluhurit, tymit, gazrave, avujve, lëndëve të ngurta dhe të lëngëta, ndikimet e reagjensëve, rrezatimit jonizues dhe jo-jonizues.
5. Dështimi për të zbatuar rregullat bazë të sigurisë në punë, mund të jenë:
- 5.1. mjetet e punës me defekt;
 - 5.2. mosmirëmbajtja e dyshemesë dhe kalimeve, si rrëshqitja dhe bllokimi i kalimeve dhe sipërfaqeve ku realizohet puna;
 - 5.3. mungesa ose parregullsia e mbrojtësve dhe pajisjeve të tjera për mbrojtjen e punonjësve nga rënia nga lartësitë ose në thellësi;
 - 5.4. mungesa ose mosfunksionimi i pajisjes mbrojtëse në makinë dhe pajisjet e punës;
 - 5.5. mungesa ose mosfunksionimi i mbrojtjes ndaj kontaktit të rastësishëm të pjesëve nën tension me rrymë elektrike;
 - 5.6. mungesa ose mosfunksionimi i mbrojtjes nga rryma elektrike e rrezikshme;

- 5.7. mungesa ose mosfunksionimi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike;
- 5.8. mungesa ose mosfunksionimi i mbrojtjes nga elektriciteti statik;
- 5.9. mungesa ose mosfunksionimi i izolimit termik;
- 5.10. mosfunksionimi i instalimeve energjetike dhe pajisjeve për bartjen e gazrave, avujve, lëngjeve, ajrit të kondicionuar;
- 5.11. mosfunksionimi i linjave të tubave për bartjen e acideve, tretjeve dhe substancave të tjera toksike dhe të rralla;
- 5.12. mungesa e pajisjeve dhe aparateve për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimet;
- 5.13. mungesa e pajisjeve dhe aparateve për mbrojtje nga temperatura e lartë ose e ulët;
- 5.14. mungesa për mbrojtje nga rrezatimi;
- 5.15. mungesa për mbrojtje nga zhurma dhe dridhjet;
- 5.16. mungesa ose mosfunksionimi i mbrojtjes nga faktorë kimik, të mjedisit të punës, toksik, gazrave dhe avujve ngacmues, toksik dhe tymit të dëmshëm dhe helmues, pluhurit dhe mjegullës, lëngjeve toksike dhe korrozive dhe reagensëve të ngurta;
- 5.17. mungesa ose mosfunksionimi i mbrojtjes nga faktorët mjedisorë biotikë bakteret, viruset, kërpudhat dhe parazitët;
- 5.18. mungesa ose mosfunksionimi i instrumenteve të sigurisë, pajisjeve dhe aparateve të sigurisë në mjedise të punës si valvulet -ventilet e sigurisë, aparatet për sinjalizim, akustik zanorë dhe optik, pajisjet automatike elektronike dhe kompjuterike për kontroll dhe udhëheqje të procesit të sigurimit;
- 5.19. mungesa e ndriçimit adekuat;
- 5.20. mungesa ose mosfunksionimi i ajrimit në hapësira punuese;
- 5.21. mungesa ose mosfunksionimi i pajisjeve për largimin e gazrave, avujve dhe pluhurit të dëmshëm; dhe
- 5.22. çrregullime në procesin teknologjik të punës.

Neni 83

1. Punëdhënësi është i detyruar të mbaj dhe evidentoj ruajtjen e dokumenteve, afatet për shqyrtimin ose kontrollin e mjedisit të punës dhe pajisjeve mbrojtëse personale.
2. Pajisjet dhe makinat për punë me rreziqe të shtuara për të cilat mbahen dhe evidentohen, afatet e realizimit të shqyrtimit dhe testimit të tyre janë:
 - 2.1. pajisjet dhe makinat për punë që shfrytëzojnë energjinë elektrike si dhe ato që punojnë me tension të ulët edhe pse janë të siguruara me izolim mbrojtës të shënuar me shenjë të veçantë sipas standardeve.

2.2. pajisjet dhe makineritë e punës të cilat punojnë me motor me djegie të brendshme ose me lloj tjetër të energjisë;

2.3. pajisjet dhe makineritë e punës të destinuara për përpunimin e substancave të rrezikshme ose që gjatë përdorimit të tyre prodhohen substanca ose rrezatim të rrezikshëm; dhe

2.4. pajisjet dhe makineritë e punës të cilat kanë enët nën presion si pjesë përbërëse dhe posedojnë valvul sigurie;

3. në hapësirat ku realizohen proceset e punës për të cilat udhëhiqet evidentimi i afateve për realizimin e shqyrtimeve, inspektimit dhe të testimit të mjedisit të punës:

3.1. ndikimi i temperaturës, lagështisë dhe shpejtësisë së lëvizjes së ajrit;

3.2. ndriçimi, zhurma dhe dridhjet;

3.3. ku prodhohet ose përdoren substanca të rrezikshme të cilat janë të dëmshme për shëndetin;

3.4. rrezatimet e rrezikshme dhe të dëmshme për shëndetin;

3.5. pajisjet mbrojtëse personale për të cilat mbahet evidentimi i afateve për shqyrtim apo ekzaminim; dhe

3.6. kohëzgjatja e përdorimit të përcaktuar me rregulla, standarde të veçanta apo sipas udhëzimit të prodhuesit;

4. evidentimi i afateve kohore për shqyrtimin dhe testimin e pajisjeve dhe makinave për punë me rreze të rritura dhe mjedisit të punës, përfshin:

4.1. numrin e evidentimit;

4.2. të dhënat e pajisjeve dhe makinerisë për punë me rrezikshmëri të lartë, hapësirat e punuese dhe hapësirat e punës jashtë, emri, shenja ose numri, vendi i lokacionit;

4.3. datën e shqyrtimit dhe testimit të pajisjeve dhe makinerisë së punës, mjedisin e punës, emrin e personit që ka realizuar shqyrtimin dhe testimin, numrin dhe datën e lëshimit të dokumentit të testimit;

4.4. të dhënat për pajisje dhe makina të atestuara që i plotësojnë kushtet e përcaktuara për përdorim të mëtejshëm;

4.5. data kur duhet të rishikohen dhe testohen pajisjet dhe makinat për punë ose mjedisi i punës në mënyrë të përcaktuar; dhe

4.6. emri dhe mbiemri i punonjësit i cili i ka regjistruar të dhënat në regjistra.

5. Evidentimi i afateve kohore për shqyrtimin dhe testimin e mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse personale i përcaktuar sipas rregullave, standardeve ose udhëzimeve të prodhuesit përfshin:
- 5.1 numrin e evidentimit;
 - 5.2. të dhënat për pajisje personale mbrojtëse dhe shënime, të tjera;
 - 5.3. data e shqyrtimit dhe testimit, emri i personit që ka realizuar shqyrtimin dhe testimin, numri dhe data e lëshimit të dokumentit të testimit;
 - 5.4. të dhënat për mjete dhe pajisje mbrojtëse personale të testuara, kushtet e përcaktuara për përdorim të mëtejshëm;
 - 5.5. data se kur duhet të rishikohen pajisjet mbrojtëse personale për punë sipas standardeve ose udhëzimeve të prodhuesit; dhe
 - 5.6. emri dhe mbiemri i punonjësit i cili i ka regjistruar të dhënat në regjistra.
6. Para se të vihen në përdorim pajisjet dhe makineritë për punë mjediset e punës si dhe pajisjet mbrojtëse personale duhet të bëhet regjistrimi i afateve kohore të shqyrtimeve të realizuara, paraprakisht duke i regjistruar të dhënat e kërkuara sipas këtij neni.
7. Mënyra e ruajtjes së dokumenteve që shfrytëzohen gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes në punë duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

XIII. LIBRAT E KONTROLLIT

Neni 84

1. Libri i kontrollit të cilin e mban punëdhënësi përbëhet nga një numër i duhur i fletëve për regjistrim të lidhura me kopër tina.
2. Në faqen e parë të librit të kontrollit në fushën e sigurisë në punë duhet të shënohet “Librit i kontrollit në fushën e sigurisë në punë”.
3. Në faqen e parë pas kopër tinave dhe fletës së parë të regjistrimit të librit të kontrollit shënohen të dhënat si në vijim:
 - 3.1. emri dhe selia e punëdhënësit, njësia e veçantë e biznesit ose vendi i punës së përkohshëm, emri, vendi dhe adresa e Njesisë Biznes ore, përkatësisht punishtes;
 - 3.2. datën e krijimit, e formimit, përkatësisht përfundimit të librit të kontrollit mbikëqyrës me datë të saktë të mbylljes përfundimit të librit kontrollues; dhe
 - 3.3. emri, mbiemri dhe funksioni i punonjësit të caktuar për regjistrimin, mbajtjen, ruajtjen dhe mbylljen e librit të kontrollit me nënshkrimin e tij.

4. Në fletën e regjistrimit, punonjësit e autorizuar, organet e punëdhënësit dhe inspektorët e minierave i shënojnë vendimet e tyre në dy kopje. Një kopje të listës së regjistrimit e mban personi i autorizuar që ka bërë regjistrimin, ose mbikëqyrësi i minierave, kurse kopja tjetër mbetet në librin e kontrollit

Neni 85

1. Punonjësit e autorizuar, punonjësit e njësisë biznes ore, dhe inspektorët e minierave shënojnë në librin e kontrollit mbikëqyrës këto të dhëna:
 - 1.1. emrin dhe funksionin e punonjësit të autorizuar,
 - 1.2. emrin dhe mbiemrin e personave të cilët në emër të organit marrin vendim dhe funksionin e tyre, përkatësisht emrin dhe mbiemrin e punonjësit të autorizuar në Trepça SH.A. ose Inspektoratin e minierave;
 - 1.3. emrin e aktit në bazë të të cilit është marrë, vendimi apo konkluzioni;
 - 1.4. të dhënat mbi identitetin dhe adresën e personit të cilit i referohet vendimi;
 - 1.5. natyra e deklaratës
 - 1.6. data e regjistrimit të vendimit në librin mbikëqyrës.
2. Vendimin duhet të nënshkruhet nga punonjësi i autorizuar ose personi i cili në emër të punonjësit të autorizuar është caktuar nga organi mbikëqyrës në njësi biznes ore ose Inspektori i minierave.
3. Në librin e kontrollit Inspektori i minierave shënon;
 - 3.1. një paralajmërim për punëdhënësin se me kërkesë të tyre do të nxjerrë vendim të veçantë me arsyetim, nëse një kërkesë e tillë ushtrohet brenda tetë ditëve nga data e regjistrimit të vendimit në librin e kontrollit;
 - 3.2. një urdhër se personi përgjegjës në njësi biznes ore- minierë , përkatësisht punëdhënësi është i obliguar që në afat prej tetë ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit të njoftojnë Inspektoratin e minierave lidhur me veprimet e ndërmarra; dhe
 - 3.3. njoftimin rreth të drejtës për ankesë.
4. Trepça Sh.A. mbanë një ose më shumë libra kontrolli në varësi të madhësisë, numrit, shtrirjes dhe veprimtarisë kryesore. Duhet të mbajnë libër të veçantë të kontrollit për çdo njësi të veçantë të biznesit, punishte të përkohshme.
5. Libri i kontrollit mbahet në njësinë organizative për të cilën është themeluar përkatësisht në njësi të veçantë ose punishte të përkohshme. Libri i kontrollit përfundon mbyllet pas plotësimit të fletës së fundit të regjistrimit.

6. Përmbajtja e raportit vjetor për lëndimet dhe sëmundjet profesionale të punonjësve në punë, bëhet në bazë të Rregullores (MZHE) Nr.02/2018 për Formën e Raportit të Aksidenteve në Punë në Miniera.

7. për zbatimin praktik të të gjitha llojeve të evidencave, aplikohen shtojcat 1, 2 dhe 3 të Rregullores (MZHE) Nr.03/2019 për Mënyrën e Mbajtjes së Evidencës dhe Ruajtjen e Dokumentacionit nga Fusha e Mbrojtjes në Punë në Veprimtari Minerare.

XIV. SHENJAT E SIGURISË

Neni 86

1. Rreptësisht ndalohet heqja e shenjave të sigurisë, keqpërdorimi dhe dëmtimi i tyre.
2. Ndaj punonjësit i cili shkelë paragrafin 1 të këtij neni, zbatohen dispozitat e Rregullores për Përgjegjësi Disiplinore dhe Materiale.

Neni 87

Me qëllim të sigurisë dhe shëndetit në punë, varësisht nga ambienti i punës, kushtet e punës dhe pajisjet dhe mjetet e punës, vendosen shenjat që paralajmërojnë rrezik, shenjat ndaluese dhe shenjat informuese.

Neni 88

1. Shenjat ndaluese:

- ndalohet hyrja e personave të paautorizuar,
- ndalohet pirja e duhanit,
- ndalohet përdorimi i flakës së hapur, -ndalohet bartja e njerëzve me pirunier,
- ndalohet kalimi dhe qëndrimi nën peshat e ngritura të vinçit,
- ndalohet kalimi dhe qëndrimi nën peshat e ngritura të pirunierit,
- ndalohet përdorimi i ashensorit në rast zjarri në objekt,
- ndalohet futja e dorës apo pjesëve tjera të trupit derisa makina është e kyçur në rrjetin elektrik apo duke punuar,
- ndalohet përdorimi i mjeteve të punës që shkaktojnë shkëndija,
- ndalohet konsumimi i pijeve dhe ushqimit,
- ndalohet konsumimi i alkoolit,
- ndalohet spërkatja me ujë,
- ndalohet hedhja e gjëseneve në kanalizim
- ndalohet parkimi,

2. Varësisht nga rrethanat ekzistuese në procesin apo vendet e punës vendosen edhe shenja tjera të kësaj natyre.

Neni 89

1. Shenjat paralajmëruese:

- rrezik nga rënia në thellësi;
- rrezik nga shembja e gurëve,
- rrezik nga pjesët rrotulluese të makinave, -rrezik nga sendet e nxehta,
- rrezik nga radioaktiviteti, -rrezik nga fushat elektromagnetike,
- rrezik nga bombolat e gazit, -rrezik nga enët me presion,
- rrezik nga materiet ndezëse, -rrezik nga tensioni i lartë,
- rrezik nga lëvizja e mjeteve të transportit të brendshëm,
- rrezik nga punimet në kulmin e objektit,
- rrezik nga amoniaku,
- rrezik nga rrëshqitja.

2. Varësisht nga rrethanat ekzistuese në procesin apo vendet e punës vendosen edhe shenja tjera atë kësaj natyre.

XV. INFORMIMI I PUNONJËSVE

Neni 90

1. Punëdhënësi merr masa adekuate ti informoj punonjësit dhe përfaqësuesit e tyre lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë, që ka të bëjë me:

1.1. masat parandaluese dhe mbrojtëse për çdo rrezik të mundshëm që mund të paraqitet në vendin e punës;

1.2. informon dhe trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në punë;

1.3. informimin e punonjësve për masat në rast zjarri, evakuimi, dhe përgjegjësitë e tyre individuale në rast nevojë për aplikimin e këtyre masave;

1.4. konstatimet me rastin e vlerësimit të rrezikshmërisë për çdo vend pune;

1.5. masat e ndërmarrura ose që duhet ndërmarrë, për sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve të rinj, grave shtatzëna, grave gjatë dhënësive dhe personave me aftësi të kufizuara.

XVI. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 91

Për shkeljen e dispozitave të kësaj Rregulloreje, pason përgjegjësia sipas dispozitave ligjore dhe dispozitave të Rregullores për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale.

XVII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE


Neni 92

Ndryshimet dhe plotësimet e këtyre dispozitave bëhen sipas procedurës e cila vlejnë për miratimin e Rregullores.

Neni 93

Kjo Rregullore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë e Shoqërisë Aksionare Trepça Sh.A. me seli në Parkun Industrial në Mitrovicë, hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga ana e Bordit Mbikëqyrës, dhe fillon të zbatohet pas tetë ditëve nga publikimi në tabelën e shpalljeve.

Kryesuesi i Bordit të Përkohshëm Mbikëqyrës


Prof. Dr. Sylejman Hyseni

